



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi*, më 15 shtator, Trupi Gjykses urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Trupi Gjykses konstatoi se vazhdon të ekzistojë rreziku se z. Krasniqi dhe z. Selimi të pengojnë ecurinë e procesit gjyqësor ose të kryejnë vepra penale të tjera kundër atyre që konsiderohen se janë kundër UÇK-së, ku përfshihen dëshmitarët që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në këtë çështje gjyqësore dhe/ose që pritet të paraqiten në gjykatë. Trupi Gjykses konstatoi gjithashtu se vetëm nëpërmjet kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të DHS-së mundësohet kufizimi i komunikimeve në një mënyrë që i zvogëlon mjaftueshëm këto rreziqe.

Gjithashtu më 15 shtator, Trupi Gjykses lëshoi vendimin mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Konstatim për Shkelje të Nxjerrjes së Materialit. Mbrojtja kishte parashtruar se deklarata e një dëshmitari përmbante prova shfajësuese dhe se ZPS-ja nuk e nxori menjëherë sikurse kërkohet sipas Ligjit. Prova shfajësuese janë prova të cilat mund të sugjerojnë pafajësinë ose mund të lehtësojnë fajësinë e të akuzuarit, dhe Ligji kërkon që Prokuroria t'ia bëjë ato të ditura Mbrojtjes menjëherë.

Trupi Gjykses konstatoi se nxjerrja e informacionit nuk u krye në kohë, por megjithatë, Mbrojtja pati kohë mjaftueshëm për ta përdorur informacionin gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit dhe se, rrjedhimisht, të akuzuarit nuk u dëmtuan nga nxjerrja e vonuar e informacionit. Trupi Gjykses përsëriti rëndësinë e përmbushjes së detyrimit të ZPS-së për nxjerrjen e materialeve në kohë dhe me zellin e duhur dhe shprehu kënaqësinë që ZPS-ja ndërmoi një numër hapash për të siguruar që kjo të mos ndodhë më. Trupi Gjykses hodhi poshtë pjesën tjetër të masave ndreqëse të propozuara nga Mbrojtja.

Të martën, 19 shtator, Trupi Gjykses lëshoi vendim lidhur me raportin e katërmbëdhjetë të Zyrës Administrative mbi kërkesat e viktimave për pjesëmarrje. Trupi Gjykses refuzoi të shqyrtonte themelësinë e kërkesave, sepse afati i fundit për dorëzimin e tyre në këtë çështje gjyqësore ishte 15 shkurti dhe, sipas mendimit të Trupit Gjykses, nuk ishin dhënë arsye bindëse për parashtrimin me vonesë të tyre. Megjithatë, Trupi Gjykses vuri në dukje se Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave mund ta dorëzojë përsëri raportin me informacion shtesë mbi arsyet për vonesën.

Deri tani, numri i viktimave pjesëmarrëse në këtë çështje gjyqësore është 141.

Seanca e radhës në këtë çështje gjyqësore është planifikuar për të hënë, 25 shtator, në orën 9:00 paradite.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, më 15 shtator, Trupi Gjykses refuzoi Mocionin e Mbrojtjes për Rrëzimin e Akuzës së Vrasjes së Paligjshme në Aktakuzë.





Mbrojtja kishte parashtruar se provat e paraqitura nga ZPS-ja në mbështetje të akuzës së vrasjes së paligjshme nuk ishin të besueshme, sepse, sipas mendimit të saj, ato bazohen në vetëm një dëshmitar që ka precedentë penalë dhe që ka dhënë dëshmi mospërputhëse.

Trupi Gjykses deklaroi se ai ka marrë prova të tjera në mbështetje të akuzës dhe, rrjedhimisht, e hodhi poshtë mocionin. Sa i përket besueshmërisë së dëshmitarit dhe mbështetshmërisë në dëshminë e tij, Trupi Gjykses konstatoi se Mbrojtja i kërkoi Trupit Gjykses që të fillonte kryerjen e një vlerësimi që nuk bëhet në këtë fazë të procesit, sepse besueshmëria dhe mbështetshmëria e provave do të vlerësohet në fund të procesit, gjatë kuvendimeve të Trupit Gjykses lidhur me fajësinë ose pafajësinë e të akuzuarit.

Mbrojtja në këtë çështje gjyqësore filloi dje paraqitjen e provave të veta, me thirrjen e dëshmitarit të parë të saj. Dhënia e dëshmisë vazhdon dhe sot. Dëshmitari quhet Bardhyl Mahmuti, dhe ai po dëshmon pa masa mbrojtëse.

Më 20 shtator, Trupi Gjykses urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Pjetër Shalës. Trupi Gjykses konstatoi se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Shala të pengojë ecurinë e procesit gjyqësor ose të kryejë vepra penale të tjera, ku përfshihen dëshmitarët që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në këtë çështje gjyqësore, dhe/ose që pritet të paraqiten në gjykatë. Trupi Gjykses konstatoi gjithashtu se vetëm nëpërmjet kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të DHS-së mundësohet kufizimi i komunikimeve në një mënyrë që i zvogëlon mjaftueshëm këto rreziqe.

Seanca e radhës në këtë çështje gjyqësore do të mbahet më 2 tetor, në orën 9:30 paradite.

Në çështjen gjyqësore *Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj*, më 18 shtator, Paneli i Gjykatës Supreme lëshoi Vendimin mbi Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë, me të cilin hodhi poshtë kërkesat në tërësi. Paneli hodhi poshtë arsyet e kërkesës duke konstatuar se nuk kishte shkelje të së drejtës penale, shkelje thelbësore të procedurës së përcaktuar nga Trupi Gjykses dhe Paneli i Gjykatës së Apelit, ose duke konstatuar se arsyet ishin të papranueshme.

Të gjitha parashtrimet publike, përfshirë vendimet e paneleve të lartpërmendura gjendet në faqen e internetit të DHSK-së.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

